

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Sot diskutojmë për buxhetin, ndaj çfarëdo aspekt të tij të trajtojmë në fjalën tonë është një vlerë për interesin publik. Mjafton të themi të vërtetën, sepse, nëse themi të kundërtën, thjesht keqinformojë.

Sigurisht që publiku nuk pret të dëgjojë sot nga ne se ky buxhet do të zgjidhë të gjitha problemet e familjeve shqiptare dhe, kur të vijë viti tjetër, hallet tona do të mbyllen, sepse nuk ka asnjë buxhet në botë sot që ta arrijë këtë objektiv, por publiku duhet të dëgjojë nëse ky buxhet do ta çojë Shqipërinë një hap para, sado të vogël, drejt Europës së dëshiruar nga të gjithë ne. Nëse kjo është e vërtetë, e në mos na i nxëntë goja ta themi, do të duhej të bënim kritikën se si mund të bëhej më mirë, por jo të themi se po bëjmë hapa pas! Kjo do të ishte thjesht një gënjeshtër e zezë.

Unë sot mund t'i shoh shqiptarët në sy dhe mund t'u them: po, ky buxhet na çon një hap para në rrugën tonë! Mund të na çonte dy hapa para, sikur të mos ishim pjesë e një Europe që po mban një barrë të pamërituar, barrën që sjell lufta.

Putinizmi i ka futur duart në xhepat e çdo familjeje sot në botë, për të marrë, në një formë a në një tjetër, ndryshe nga disa këtu, në këtë sallë, ku duart në xhepa ua futi për t'u lënë rublat, me të cilat bleu shpirtin e ndyrë të matrapazit, që është i gatshëm të shesë edhe atdheun! Ndryshe nga kjo farësoj, putinizmi i ka futur duart edhe në xhepat tanë, duke shkaktuar një reaksion zinxhir inflacionist, por do të ishte edhe më prezent në familjet tona nëse kjo qeveri, përmes këtij buxheti, nuk do të vendoste barriera.

Sot, kur takon një të huaj, pyetja e parë që të bën është: "Sa ju është rritur fatura e energjisë elektrike?". Dhe ne, sigurisht, me njëfarë krenarie, i themi se këtë lloj vuajtje nuk e kemi. Kjo nuk është pak! Edhe në këtë krizë, po aq ekzogjene sa dhe pandemia e tërmeti, qeveria mori përsipër rolin e një barrikade që mban goditjen kryesore, por le të mos e quajmë meritë të jashtëzakonshme, sepse ky është roli që ajo vetë ka zgjedhur të ketë për këtë vend!

A do të thotë kjo se me kaq përfundon misioni i këtij buxheti? Jo, sepse kjo do të thoshte thjesht ruajtje të statusquo-së.

Buxheti i vitit 2023 nuk ka munguar të çojë para, përpjesëtimisht me mundësitë, prioritetet që i ka identifikuar si thelbësore për rritjen e qëndrueshme.

Përmes alokimeve të diferencuara, që mundësojnë ndryshimet strukturore të nevojshme, qeveria po ecën drejt qëllimeve që i ka bërë publike tashmë.

Kështu, do të kemi një administratë tatimore më eficiente, që mbledh më shumë të ardhura (29% e GDP-së, kundrejt 28,2% që ishte).

Rritja ekonomike do të sigurohet nga 3 komponentë: 1) më shumë kapital fizik, sepse 5,6% e GDP-së shkon për investime; 2) arsimim më cilësor, sepse ky buxhet jep më shumë mbështetje për paga, aktivitet akademik dhe ndërkombëtarizim të arsimit të lartë; 3) rritje produktiviteti, sepse ky buxhet parashikon zgjerim të dixhitalizimit, pa të cilin nuk mund të kemi integrim në zinxhirët e prodhimit global.

Kjo tregon se ky buxhet një gjë e bën me siguri: hedh hapa drejt një ekonomie më të madhe, dhe nga një ekonomi më e madhe më shumë gjëra të mira mund të bëhen.

A do thotë kjo se qeveria, me kaq shumë angazhime, po fut financat publike në risk? Jo, sepse i gjithë ky zhvillim i harmonizuar në tërësinë e vet, pa cenuar asnjë rezultat pozitiv të arritur, por duke guxuar të kërkojë progres në disa sektorë të rëndësishëm si bujqësia, mbrojtja dhe shëndetësia, bëhet nën objektivin e konsolidimit fiskal. Borxhi publik dhe deficitin fiskal targetohen në nivele më të ulëta se në vitin 2022.

Një këshillë për kolegët opozitarë: mos i takoni virtualisht ndërkombëtarët, duke qëmtuar shifra krahasuese në internet, sepse ne nuk pretendojmë ta bëjmë “kungullin” “karrocë të artë”! Kolegët opozitarë do të bënin mirë t’i takonin dhe t’i dëgjonin ballë për ballë ndërkombëtarët, se ndoshta kështu do të mësonin shumë më tepër nga statistikat e internetit, që, në fakt, të vendosura në kontekstin e gabuar, bëjnë vetëm një gjë: çorientojnë.

Kam një këshillë edhe për kolegët ministra, që të mbajnë shënim me kujdes të gjitha vërejtjet dhe kritikën, pavarësisht se nga vijnë, pasi disa prej tyre mund t’u vlejnjë gjatë punës së ardhshme!

Sa për mua, duke uruar që ato çfarë dëgjuam sot, të kthehen nga një plan në një fakt pas një viti, e mbështes plotësisht projektbuxhetin, i bindur se ky është buxheti më i mirë i mundshëm në kohën që po jetojmë! Faleminderit!